



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Përmbledhja e Pulsit Publik XXIII

Nëntor 2022

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it.

PËRMBAJTJA

Lista e Tabelave	2
Lista e Figurave	2
Përmbledhje ekzekutive	4
Treguesit kyç të Pulsit Publik.....	6
Drejtimi politik	7
Siguria personale	8
Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	9
Drejtimi ekonomik.....	12
Problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht	13
Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat.....	14
Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë	16
Qëndrimet kundrejt votimit.....	18
Mjedisi.....	22
Metodologjia	27
Peshimi i totaleve të popullatës	27
Përlllogaritja e Indekseve.....	28

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë.....	6
Tabela 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së.....	11
Tabela 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së	12
Tabela 4 Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë	19

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës.....	7
Figura 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike	8
Figura 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë.....	9
Figura 4 Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike	10
Figura 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës	12
Figura 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht.....	14
Figura 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik.....	15
Figura 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat	16
Figura 9 Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë	18
Figura 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	19
Figura 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	19
Figura 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	20
Figura 13 Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti	21
Figura 14 Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike.....	22
Figura 15 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër	23
Figura 16 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike.....	24
Figura 17 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre	25
Figura 18 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike.....	25
Figura 19 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë	26
Figura 20 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike	26

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbledhjet e Pulsit Publik i pasqyrojnë gjetjet për dhjetë treguesit kyç në lidhje me çështjet socio-ekonomike, mjedisore dhe politike. Ato bazohen në anketat gjashtëmujore të opinionit që kryhen dy herë në vit me të anketuar mbi 18 vjeç në Kosovë.¹ Përmbledhja e Pulsit Publik XXIII raporton për gjetjet nga anketa e opinionit e realizuar me 1,306 të anketuar nga data 21 tetor deri më 3 nëntor 2022 në mbarë territorin e Kosovës, me numër të barabartë të meshkujve dhe të femrave si dhe me të gjitha grupet etnike që jetojnë në Kosovë. Të dhënat dhe treguesit nga anketa e opinionit zërthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptimet për sfidat zhvillimore me të cilat përballen qytetarët në Kosovë.

Në anketën e opinionit tetor-nëntor 2022 (më tej e referuar si anketa e nëntorit 2022), niveli i kënaqshmërisë me performancën e kabinetit ekzekutiv kapi vlerën prej 41%, një rënie për 6.2 pikë përqindje nga anketa e prillit 2022 kur ishte 47.2%. Niveli i kënaqshmërisë me punën e Kryeministrit kapi vlerën prej 44.9%, një rënie për 7.7 pikë përqindje nga prilli 2022 kur ishte 52.6%. Kënaqshmëria me punën e Kuvendit kapi vlerën prej 39.1%, kundrejt 50.2% në prill 2022, ndërsa kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit të Kosovës ishte 50.8%, krahasuar me 54.4% në prill 2022. Niveli i kënaqshmërisë me Presidenten kapi vlerën prej 56.8% krahasuar me 58.4% në prill 2022. Ulje të dukshme pati edhe në shkallën e kënaqshmërisë me Gjykatat dhe Zyrën e Kryeprokurorit, në nivelin prej 24.4% dhe 22% përkatësisht, krahasuar me 33.9% dhe 37.1% përkatësisht në prill 2022.

Indeksi i Demokratizimit (ID) u ul për 0.14 pikë (1.52) krahasuar me prillin 2022 kur kjo vlerë ishte 1.66 pikë. Në mënyrë të ngjashme, Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) është ulur për 0.12 pikë (0.86) nga prilli 2022, kur ishte 0.98 pikë. Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë qëndrim pozitiv të shumicës së qytetarëve në lidhje me indekset e demokratizimit dhe ekonomisë.

Një numër dukshëm më i ulët i të anketuarve ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në nëntor 2022 sesa në prill 2022 (37.6%). Ky është numri më i ulët i të anketuarve të gatshëm të protestojnë për arsye politike i regjistruar ndonjëherë nga Pulsi Publik. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan rënie të gatishmërisë për të protestuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, dhe rritje të gatishmërisë për të protestuar për arsye politike në mesin e serbëve të Kosovës. Kjo vlerë në mesin e shqiptarëve të Kosovës ishte 24.3% krahasuar me 39.4% në prill 2022, dhe 11% në mesin e serbëve të Kosovës krahasuar me 6.7% në prill 2022, dhe 21% në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës krahasuar me 30% në prill 2022.² Pjesa më e madhe e të pakënaqurve me drejtimin politik në Kosovë ishte në mesin e serbëve të Kosovës (41.4%), të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës (35.5%) dhe shqiptarët e Kosovës (31.1%). Në përgjithësi, 42.6% e të anketuarve ishin të pakënaqur dhe 23.16% ishin të kënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës.

¹Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

²Për qëllimet e kësaj ankete të opinionit, termi "komunitete të tjera të Kosovës" përfshin ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës.

Gjetjet nga anketa e opinionit e nëntorit 2022 tregojnë ngjashmëri për sa i përket ndjenjës së sigurisë tek të anketuarit krahasuar me prillin 2022, me 80.4% që ndihen të sigurt kur janë jashtë në nëntor 2022, krahasuar me 80.41% në prill 2022. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se meshkujt (81.1%) ndihen pak më të sigurt kur janë jashtë sesa femrat (79.8%). Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është ulur për 30.8 pikë përqindje, me 15.3% që ndihen të sigurt në nëntor 2022, krahasuar me 46.1% në prill 2022. Ndjenja më e lartë e sigurisë është regjistruar tek shqiptarët e Kosovës me 83.3% (81.6% në prill 2022) që ndihen të sigurt kur janë jashtë, të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (79.5%), ndjenja e sigurisë së të cilëve është ulur gjithashtu për 9 pikë përqindje (88.5% në prill 2022).

Anketa e Pulsit Publik e nëntorit 2022 i hulumtoi edhe problemet më urgjente me të cilat përballet Kosova aktualisht. Të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin një temë që ata mendonin se ishte problemi më urgjent. Gjetjet tregojnë ngjashmëri me problemet kryesore të perceptuara në prill 2022: papunësia (29.9%), varfëria (21%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (17.4%) perceptohen si tre problemet kryesore në Kosovë. Furnizimi me energji elektrike (4.3%) dhe shëndetësia (4.1%) ishin ndër pesë problemet kryesore të identifikuara nga të anketuarit. Vlen të theksohet se krahasuar me prillin 2022, shkalla e atyre që e konsideronin korrupsionin si problem madhor (5%) ka rënë për 3.6 pikë përqindje në nëntor 2022, ku vetëm 1.4% e të anketuarve e konsiderojnë korrupsionin si problem madhor. Nga ana tjetër, krahasuar me prillin 2022, shkalla e atyre që i konsideruan si problem madhor çmimet e furnizimeve esenciale (7.7%) është rritur për 9.9 pikë përqindje. Serbët e Kosovës i konsideruan furnizimin me energji elektrike (20.5%), marrëdhëniet ndëretnike (11.9%) dhe problemet e hapësirës urbane (10%) si tre çështjet më urgjente, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh ishte varfëria (22.5%), e ndjekur nga papunësia (18%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (16.5%). Si në anketën e mëparshme, për shqiptarët e Kosovës, papunësia (31.6%), varfëria (21.5%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (18.3%) ishin tre problemet madhore në Kosovë. Gjithsej 71.3% e të anketuarve konsiderojnë së punësimi në institucionet publike në Kosovë nuk bëhet në baza meritore, krahasuar me prillin 2020 kur këtë e besonin 75% e të anketuarve. Mesatarisht, 21.1% e anketuarve pohojnë se e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, një rritje për 1.1 pikë përqindje nga prilli 2022 (22.2%).

Gjithsej 31.2% e të anketuarve besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime kundrejt 32.4% që nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë. Gjithsej 69% e të anketuarve do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin së shpejti.

Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, 8.9% e të anketuarve thanë se dinë shumë për këtë temë, 26.2% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 46.1% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 18.8% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, një rritje për 1.7 pikë përqindje krahasuar me prillin 2022 (17.1%).

Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të bëhen të disponueshme përmes Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik dhe ASKData.³

³ Platforma për Vizualizimin e të Dhënave: <https://app.powerbi.com/view?r=eyJrJoiNTUzMjZjZjAtNmZIMC00NmQ2LTg3YjAtNmZmOWY2MTNiMTBliwidCl6lmlzZTVkYjVlLTl5NDQtNDgzNy05OWY1LTc0ODhhY2U1NDMxOSlsmMiOjh9ASKData> është një platformë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës: <https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pjweb/sq/askdata/>.

TREGUESIT KYÇ TË PULSIT PUBLIK

Anketa e opinionit e nëntorit 2022 ka treguar se mesatarisht, 39.9% e të anketuarve ishin të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës krahasuar me 48.4% në prill 2022, 47% në vjeshtën e 2021, 51.4% në maj 2021, 27.5% në dhjetor 2020 dhe 42.5% në prill 2020.

Kënaqshmëria me punën e Presidentes së Kosovës kapi vlerën prej 56.8%, krahasuar me 58.4% në prill 2022, 55.2% në vjeshtën e 2021 dhe 63.7% në maj 2021. Kënaqshmëria me punën e Kryeministrit kapi vlerën prej 44.9% (52.6% në prill 2022, 53.2% në vjeshtën e 2021 dhe 59.5% në maj 2021). Kënaqshmëria me kabinetin ekzekutiv të Kosovës ishte 41% krahasuar me 47.2% në prill 2022, 47.6% në vjeshtën e 2021 dhe 59.1% në maj 2021. Niveli i kënaqshmërisë me Kryetarin e Kuvendit ishte 50.8% (55.4% në prill 2022, 55.4% në vjeshtën e 2021 dhe 59.2% në maj 2021), ndërsa kënaqshmëria me punën e Kuvendit të Kosovës ishte 39.1% (50.2% në prill 2022, 50.3% në vjeshtën e 2021 dhe 52.9% në maj 2021).

Ulje është vërejtur edhe në nivelin e kënaqshmërisë me performancën e gjykatave (24.4%) krahasuar me 39.1 në prill 2022, 33.9% në vjeshtën e 2021 dhe 34.6% në maj 2021. Ulje e ngjashme e kënaqshmërisë është shënuar edhe me Zyrën e Kryeprokurorit. Gjithsej 22% e të anketuarve kishin pikëpamje pozitive për punën e Kryeprokurorit, krahasuar me 37.1% në prill 2022, 34% në vjeshtën e 2021 dhe 30.8% në maj 2021.

TABELA 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë


TREGUESIT POLITIK		maj 2019	nëntor 2019	prill 2020	dhjetor 2020	maj 2021	nëntor 2021	prill 2022	nëntor 2022	Trendi
KËN- AQSHMËRIA ME KABINETIN EKZEKUTIV	Kabineti Ekzekutiv	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	47.60%	47.20%	41.00%	
	Kryeministri	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	53.20%	52.60%	44.90%	
KËN- AQSHMËRIA ME LEGJISLA- TIVIN	Kuvendi	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	50.30%	50.20%	39.10%	
	Kryetari i Kuvendit	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	55.40%	54.40%	50.80%	
KËN- AQSHMËRIA ME PRESIDENTEN	Presidentja	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	55.20%	58.40%	56.80%	
KËN- AQSHMËRIA ME GJY- QËSORIN	Gjykata	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	33.90%	39.10%	24.40%	
	Prokuroria	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	34.00%	37.10%	22.00%	

DREJTIMI POLITIK

Përqindja e të anketuarve që ishin shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës është rritur lehtë për 0.4 pikë përqindje (23.6%) krahasuar me prillin e 2022 (23.2%). Numri i atyre që ishin shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës është rritur gjithashtu për 1.8 pikë përqindje (44.4%) krahasuar me 42.6% të regjistruar në prill 2022. Megjithatë, kjo shkallë e pakënaqshmërisë është më e ulët se në dhjetor 2020 (59.4%) dhe prill 2020 (69.6%). Numri i atyre që ishin neutralë është ulur (32%) krahasuar me prillin e 2022 (34.2%) dhe vjeshtën 2021 (36.1%).


Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë dallime të vogla në mes të meshkujve dhe femrave sa i përket kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës, ku 24.2% e femrave dhe 22.8% e meshkujve janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Po kështu, meshkujt duken të jenë më të pakënaqur (46.5%) sesa femrat (42.5%) me drejtimin politik të Kosovës. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime në nivelin e kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës mes shqiptarëve të Kosovës (23.9%) dhe komuniteteve të tjera të Kosovës (28%). Niveli i kënaqshmërisë në mesin e serbëve të Kosovës ka rënë në krahasim me prillin 2022 nga 8.1% në 1.9% në nëntor 2022. Niveli më i lartë i pakënaqësisë gjendet tek serbët e Kosovës (54.3%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (49.2%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (36%). Përqindja e atyre që janë neutralë në vlerësimin e tyre për drejtimin politik të Kosovës është mjaft e lartë, me 41.4% të serbëve të Kosovës, 35.5% të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 31.1% të shqiptarëve të Kosovës që janë neutralë.

FIGURA 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës



Një numër dukshëm më i ulët i të anketuarve ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në nëntor 2022 sesa në prill 2022 (37.6%). Ky është numri më i ulët i të anketuarve të gatshëm të protestojnë për arsye politike i regjistruar ndonjëherë nga Puls i Publik. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan rënie të gatishmërisë për të protestuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, dhe rritje të gatishmërisë për të protestuar për arsye politike në mesin e serbëve të Kosovës. Kjo vlerë në mesin e shqiptarëve të Kosovës ishte 24.3% krahasuar me 39.4% në prill 2022, dhe 11% në mesin e serbëve të Kosovës krahasuar me 6.7% në prill 2022, dhe 21% në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës krahasuar me 30% në prill 2022.


FIGURA 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike



SIGURIA PERSONALE

Për ta matur perceptimin për sigurinë publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Gjetjet treguan ngjashmëri në ndjenjën e sigurisë në nëntor 2022 (80.43%) dhe prill 2022 (80.41%). Niveli më i lartë i sigurisë u regjistrua në prill 2020, kur 86.3% e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt për sa i përket dhunës dhe krimit potencial.

FIGURA 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë



Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë treguan se meshkujt (81.1%) ndihen më të sigurt kur janë jashtë sesa femrat (79.8%). Në prill 2022, të dhënat e zërthyera sipas gjinisë treguan një ndjenjë të njëjtë për sigurinë mes femrave (80.5%) dhe meshkujve (80.4%). Ndjenja e sigurisë tek femrat është ulur lehtë për 0.7 pikë përqindje. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është ulur për 30.8 pikë përqindje, me 15.3% që ndihen të sigurt në nëntor 2022, krahasuar me 46.1% në prill 2022. Ndjenja më e lartë e sigurisë është regjistruar tek shqiptarët e Kosovës me 83.3% (81.6% në prill 2022) që ndihen të sigurt kur janë jashtë, të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (79.5%), ndjenja e sigurisë së të cilëve është ulur gjithashtu për 9 pikë përqindje (88.5% në prill 2022).


INDEKSET E DEMOKRATIZIMIT DHE BESUESHMËRISË EKONOMIKE

Anketa e opinionit e Pulsit Publik e prillit 2022 regjistroi ulje si në Indeksin e Demokratizimit (ID) ashtu edhe në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE).⁴ ID-ja aktuale u ul për 0.14 pikë (1.52) krahasuar me prillin 2022 kur kjo vlerë ishte 1.66 pikë. Sidoqoftë, kjo shifër (1.52) sugjeron se më shumë se gjysma e qytetarëve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për proceset demokratike në Kosovë.

Në mënyrë të ngjashme, IBE-ja është ulur për 0.12 pikë (0.86) nga prilli 2022 kur ishte 0.98 pikë. Kjo shifër (0.86) sugjeron se më pak se gjysma njerëzve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për ekonominë.

⁴ID-ja dhe IBE-ja janë masa të vazhdueshme nga 0 në 3, në të cilat një rezultat nga 0 në 1.5 nënkupton se shumica e popullatës e sheh negativisht demokracinë apo trendet ekonomike, dhe rezultati nga 1.5 në 3 nënkupton se shumica e popullatës e sheh pozitivisht demokratizimin ose trendet ekonomike.

FIGURA 4 Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike



Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja janë të përbëra nga një numër komponentësh që përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentë të paraqitur në Tabelën 2 më poshtë. Pyetjet për këtë indeks mund të përgjigjen me "Po, plotësisht", "Po, kryesisht", "Jo aq shumë", ose "Aspak". Tabela 2 e tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me "Po, plotësisht" ose "Po, kryesisht" në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e ID-së, të dhënat nga anketa e opinionit e nëntorit 2022 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Gjetjet tregojnë se çdo komponent i ID-së i listuar në Tabelën 2 ka dëshmuar ulje krahasuar me prillin e 2022. Gjithsej 69% e të anketuarve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare, krahasuar me 73.4% në prill 2022, 70.9% në vjeshtën e 2021 dhe 70.4% në maj 2021. Përkundër rënies së përgjithshme të ID-së, ky ishte komponenti më i vlerësuar i ID-së. Gjithsej 61% konsiderojnë se Kuvendi e monitoron performancën e ekzekutivit, krahasuar me 67.5% në prill 2022, 63% në vjeshtën e 2021 dhe 60.1% në maj 2021. Komponenti me vlerësimin më të ulët është gjyqësori me 34.5%, i cili ka shënuar rënie të konsiderueshme nga prilli 2022 (41.7%), vjeshta 2021 (44.9%) dhe maji 2021 (37.5%). Gjithsej 62% e të anketuarve konsiderojnë se mediat e gëzojnë lirinë e shprehjes – duke treguar një rënie për 7.6 pikë përqindje nga prilli i 2022 (69.6%). Kjo shifër mbetet më e lartë se në vjeshtën e vitit 2021 (60.7%), por më e ulët se në maj 2021 (69.2%). Rënie është vërejtur edhe në perceptimet mbi rolin e organizatave të shoqërisë civile si monitorues të sinqertë të ekzekutivit, me 49.8% që besojnë se kjo është e vërtetë krahasuar me 61.9% në prill 2022, 55.6% në vjeshtën e 2021 dhe 56.6% në maj 2021.

Rënie e ngjashme e kënaqshmërisë mund të vërehet me punën e qeverisjes lokale dhe atë të ekzekutivit qendror. Ndërsa e para pati një rënie nga 55.8% në prill 2022 në 51.4% në nëntor 2022, e dyta ra nga 56.8% në prill 2022 në 44.5% në nëntor 2022. Vërehet një ulje në përgjigjet pozitive në pyetjen nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, me 59.1% përgjigje pozitive krahasuar me 63.1% në prill 2022. Për fundi, krahasuar me prillin 2022 (59.6%) vërehet një rënie për 8.6 pikë përqindje edhe në përgjigjet në pyetjet nëse proceset demokratike në Kosovë janë krijuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur (51%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike të nëntorit 2022 treguan se ngjashëm me anketat e mëparshme, shumica e serbëve të Kosovës u përgjigjën me "Aspak" dhe "Jo aq shumë" në të gjitha pyetjet e komponentëve të

ID-së. Shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës u përgjigjën me “Aspak” dhe “Jo aq shumë” në pyetjet e lidhura me shoqërinë civile që shërben si monitorues i sinqertë i proceseve demokratike; në pyetjen nëse ekzekutivi qendror punon sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës; dhe në pyetjen nëse proceset demokratike janë krijuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur përkundër politikës ditore. Shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës u përgjigjën me “Po plotësisht” dhe “Po kryesisht” në pyetjet e komponentëve të ID-së.

TABELA 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së

Po Kryesisht dhe Po plotësisht	maj 2019	nëntor 2019	prill 2020	dhjetor 2020	maj 2021	nëntor 2021	prill 2022	nëntor 2022	Trendi
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	35.60%	62.73%	66.30%	45.87%	70.44%	70.88%	73.42%	69.02%	
A e monitoron Kuvendi performancën e kabinetit ekzekutiv?	38.10%	38.61%	58.00%	45.56%	60.13%	62.95%	67.47%	61.00%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	21.50%	31.48%	39.70%	36.66%	37.50%	44.88%	41.67%	34.49%	
A e gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	45.60%	46.66%	69.10%	57.94%	69.24%	60.70%	69.60%	62.02%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	32.60%	34.79%	50.70%	45.77%	56.56%	55.62%	61.89%	49.83%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	29.80%	29.62%	56.70%	41.53%	52.64%	54.88%	55.82%	51.38%	
A punon kabineti qendror ekzekutiv i Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	18.10%	24.23%	54.90%	30.61%	54.39%	49.28%	56.78%	44.51%	
A janë kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	33.40%	40.30%	64.00%	42.82%	58.07%	59.49%	63.05%	59.07%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt së ardhmes, a e pranoi se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	22.40%	33.01%	42.50%	36.22%	58.65%	55.65%	59.63%	51.00%	

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive për komponentët e IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme të opinionit, siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë “të favorshme”, “jo të favorshme” dhe “neutrale”. Gjithsej 11.2% e të anketuarve kishin pritshmëri të favorshme për të hyrat totale të familjes së tyre brenda gjashtë muajve të ardhshëm, që është vlerë më e ulët se në prill 2022 (17.2%). Vërehet rritje në këndvështrimin pozitiv në mënyrën se si i shohin të anketuarit kushtet për të bërë biznes në Kosovë, me 8.2% që i konsiderojnë të favorshme – rritje nga 7.3% në prill 2022. Rritje e lehtë krahasuar me prillin 2022 (6.3%) vërehet në perceptimet e të anketuarve për kushtet aktuale të punësimit, ku 7.1% i konsiderojnë si të favorshme. Për fund, vërehet një rënie në mënyrën si i shohin të anketuarit kushtet e ardhshme të punësimit - gjashtë muaj nga an-

keta e opinionit e nëntorit 2022 - gjithsej 8.3% i shohin si të favorshme, krahasuar me 10.5% në prill 2022. Si përmbledhje, përgjigjet në komponentët e IBE-së sugjerojnë se më pak se gjysma e qytetarëve të Kosovës (0.86) kanë pikëpamje optimiste për ekonominë.


TABELA 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së

Të favorshme	maj 2019	nëntor 2019	prill 2020	dhjetor 2020	maj 2021	nëntor 2021	prill 2022	nëntor 2022	Trendi
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjatë muaj nga sot?	11.60%	13.70%	14.20%	11.50%	15.90%	15.90%	17.20%	11.20%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit?	5.50%	9.10%	8.20%	7.20%	4.70%	12.80%	7.30%	8.20%	
Cili është vlerësimi juaj për kushtet aktuale të punësimit?	5.80%	7.40%	6.60%	5.60%	7.00%	10.80%	6.30%	7.10%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjatë muaj nga sot?	4.60%	12.00%	11.60%	8.30%	18.80%	15.90%	10.50%	8.30%	

DREJTIMI EKONOMIK

Ulja në perceptimet pozitive, krahasuar me prillin 2022, është vërejtur edhe në kënaqshmërinë e të anketuarve me drejtimin ekonomik të Kosovës. Gjatë nëntorit 2022, 10.8% e të anketuarve ishin të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës për dallim nga 17.2% në prill 2022 dhe 22.3% në vjeshtën 2021. Rrjedhimisht, numri i të pakënaqurve është rritur nga 50.8% në prill 2022 në 57.2% në nëntor 2022. Gjithsej 32% nuk janë as të kënaqur e as të pakënaqur. Teksa 12.9% e meshkujve janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, vetëm 8.8% e femrave ndihen njësoj. Për rrjedhojë, 56.5% e meshkujve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, kundrejt 57.6% të femrave që ndihen njësoj. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike sugjerojnë se niveli i pakënaqësisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës është më i larti me 57.8%, ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (49.5%) dhe serbët e Kosovës (47.1%). Prandaj, grupi më i kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës janë të anketuarit nga komunitetet e tjera të Kosovës (18.5%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (11%) dhe serbët e Kosovës (2.9%).

FIGURA 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës




PROBLEMET MADHORE ME TË CILAT PËRBALLET KOSOVA AKTUALISHT

Anketa e Pulsit Publik e nëntorit 2022 u kërkoi të anketuarve edhe të zgjedhin një nga problemet më të ngutshme me të cilat përballet Kosova aktualisht. Gjetjet tregojnë shqetësime të ngjashme për problemet madhore të perceptuara në prill 2022: papunësia (29.9%), varfëria (21%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (17.4%) perceptohen si tre problemet kryesore në Kosovë. Furnizimi me energji elektrike (4.3%) dhe shëndetësia (4.1%) ishin ndër pesë problemet kryesore të identifikuara nga të anketuarit. Vlen të theksohet se krahasuar me prillin e 2022, shkalla e atyre që e konsideronin korrupsionin si problem madhor (5%) ka rënë për 3.6 pikë përqindje në nëntor 2022, ku vetëm 1.4% e të anketuarve e konsiderojnë korrupsionin si problem madhor.

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se serbët e Kosovës i konsideruan furnizimin me energji elektrike (20.5%), marrëdhëniet ndëretnike (11.9%) dhe problemet e hapësirës urbane (10%) si tre çështjet më të ngutshme, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës problemi më i madh ishte varfëria (22.5%), e ndjekur nga papunësia (18%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (16.5%). Si në anketën e mëparshme, për shqiptarët e Kosovës, papunësia (31.6%), varfëria (21.5%) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (18.3%) ishin tre problemet madhore në Kosovë.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt dhe femrat janë kryesisht të shqetësuar për papunësinë, varfërinë dhe çmimet e furnizimeve esenciale. Ngjashëm me anketën e fundit të opinionit, femrat ishin më të shqetësuara për papunësinë (31%) sesa meshkujt (28.9%). Si femrat (20.6%) ashtu edhe meshkujt (21.2%) duket se janë njëjloj të shqetësuar për varfërinë. Megjithatë, femrat ishin më të shqetësuara për çmimet e furnizimeve esenciale (19%) sesa meshkujt (15.7%).

FIGURA 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballlet Kosova aktualisht




REKRUTIMI NË BAZA MERITORE NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT

Anketa e opinionit e nëntorit të 2022 tregon se 27% e të anketuarve mendojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, kurse 71% mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Gjetjet tregojnë një rënie të lehtë të besimit në punësimin në baza meritore krahasuar me prillin e 2022 kur kjo shifër ishte 25%. Të anketuarit i konsiderojnë faktorët vijues kryesorë për punësim në sektorin publik: lidhja partiake (28.1%), lidhjet familjare (28.1%), arsimi (19.4%), ryshfeti (8.6%), shoqëria (6.4%), përvoja profesionale (5.3%), aftësimi profesional (2.5%) dhe, në masë më të vogël, paraqitja (1.8%), dhe gjinia (0.1%). Gjithsej 27% e të anketuarve besojnë se arsimi, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorët më të rëndësishëm për sigurimin e punësimit në sektorin publik.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat kanë më shumë besim tek punësimi në baza meritore sesa meshkujt. Gjithsej 30.2% e femrave besojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, krahasuar me 24.2% të meshkujve që mendojnë të njëjtën gjë. Për meshkujt, lidhjet familjare ishin mënyra më e lehtë për punësim në sektorin publik (31.4%), ndërsa për femrat, lidhja partiake ishte mënyra më e dobishme për të gjetur punë në sektorin publik (26.8%).

Ngjashëm me anketën e mëparshme, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se lidhjet partiake duket se janë faktori kyç për sigurimin e punësimit për shqiptarët e Kosovës (29.4%) dhe serbët e Kosovës (23.3%), kurse për komunitetet e tjera të Kosovës është arsimi (30%) që e mundëson punësimin në sektorin publik. Ngjashëm me tre anketat e mëparshme (maj 2021, vjeshtë 2021 dhe prill 2022), besimi më i ulët në punësimin në baza meritore gjendet mes serbëve të Kosovës (24.8%), ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (26.7%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (41%). Ngjashëm me anketën e fundit (prill 2022), këta të fundit e kanë besimin më të lartë në punësimin në baza meritore, me arsimin, përvojën profesionale dhe aftësimin profesional si faktorë vendimtarë për punësimin në sektorin publik.

FIGURA 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik




Në krahasim me anketën e prillit 2021, besimi në punësimin në baza meritore në sektorin privat u rrit nga 45% në 53% me shumicën e të anketuarve që kanë besim në punësimin në baza meritore në sektorin privat. Ngjashëm me anketën e mëparshme, të anketuarit i identifikuan faktorët e mëposhtëm jo meritore për të siguruar punësim në sektorin privat: lidhjet familjare (22.4%), miqtë (16.9%), ryshfeti (2.3%), lidhja partiake (1.9%), paraqitja e jashtme (1.9%) dhe, në masë më të vogël, gjinia (0.3%). Përvoja profesionale (37.1%) ishte kriteri më i dobishëm për punësimin në sektorin privat.

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (54.5%) kanë më shumë besim në punësimin në baza meritore në sektorin privat sesa femrat (51.6%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të moderuara mes komuniteteve në perceptimet rreth meritokracisë në sektorin privat. Më shumë besim në meritokracinë si kriter për punësim në sektorin privat kanë shqiptarët e Kosovës me 53.7%, ndjekur nga pjesëtarët e komu-

niteteve të tjera të Kosovës me 51% që kanë besim, dhe serbët e Kosovës, të cilët kanë më së paku besim në meritokraci me 40%.

FIGURA 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat



PERCEPTIMET PËR KORRUPSIONIN NË SHKALLË TË GJERË

Mesatarisht, 21.1% e anketuarve pohojnë se e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, një rritje për 1.1 pikë përqindje nga prilli 2022 (22.2%). Kjo vlerë paraqet rënie për 2.3 pikë përqindje nga vjeshta e 2021 (23.4%), 3.9 pikë përqindje nga maji i 2021 (25%), 6.9 pikë përqindje nga dhjetori i 2020 (28%), si dhe rritje për 1.1 pikë përqindje krahasuar me prillin e 2020 (20.7%). Ky rezultat tregon një trend të qëndrueshëm pozitiv në perceptimin e përgjithshëm për korrupsionin në shkallë të gjerë krahasuar me vitet e mëparshme, siç tregohet në Tabelën 4.

Organizatat ndërkombëtare janë perceptuar si më së paku të korruptuara me 12.2% që besojnë se ka prani të korrupsionit në shkallë të gjerë, të ndjekura nga Policia e Kosovës (13.5%), Arsimi (14.3%), Bankat (14.7%) dhe Shëndetësia (18.6%). Organizatat më të korruptuara perceptohen të jenë Gjykatat (30.8%), ndjekur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (28.8%) dhe Dogana (26.9%). Ndryshimet më të mëdha në perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: Dogana (26.9% krahasuar me 36.2% në prill 2022), institucionet qendrore të Kosovës (20.1% krahasuar me 13.9% në prill 2022) dhe Bankat (14.7% krahasuar me 20.5% në prill 2022). Siç tregohet në tabelën e mëposhtme, nëntë sektorë dhe organizata u perceptuan të jenë më pak të korruptuara sesa në prill 2022 dhe pesë u perceptuan të jenë më të korruptuara se në prill 2022. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se perceptimi i meshkujve për praninë e korrupsionit në


shkallë të gjerë në institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, ishte më i lartë se ai i femrave.

TABELA 4 Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë

Po Kryesisht dhe Po plotësisht	maj 2019	nëntor 2019	prill 2020	dhjetor 2020	maj 2021	prill 2021	prill 2022	nëntor 2022	Trendi
Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	25.10%	33.40%	11%	25%	22.90%	18.80%	18.10%	18.60%	
KEDS	40.70%	38.90%	27.30%	28.70%	26.10%	25.80%	26.50%	24.50%	
KEK				27.50%	25.30%	25.80%	26.70%	23.00%	
Gjykatat	29.30%	41.40%	30.60%	39.20%	34.30%	32.30%	36.20%	26.90%	
Doganat	30.70%	42.00%	24.50%	31.60%	32.50%	27.70%	27.90%	30.80%	
Administrata qendrore/ qeveria	36.70%	35.30%	20.80%	29.50%	23.10%	19.50%	13.90%	20.10%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	40.70%	48.10%	36.60%	39.00%	39.30%	29.40%	32.60%	28.80%	
Komunat (qeverisja lokale)	25.80%	29.80%	13.30%	24.70%	20.40%	19.10%	16.30%	18.40%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	20.70%	26.10%	13.60%	19.50%	15.10%	16.80%	12.10%	14.30%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)	35.30%	42.20%	18.90%	30.20%	27.40%	28.80%	25.40%	24.10%	
PTK	44.20%	40.80%	37.90%	33.20%	31.60%	23.70%	25.90%	25.30%	
Bankat	33.80%	34.10%	18.90%	28.10%	22.90%	22.20%	20.50%	14.70%	
Organizatrat ndërkombëtare	19.50%	23.60%	5.50%	23.80%	15.70%	17.60%	14.00%	12.20%	
Policia e Kosovës (PK)	17.00%	20.70%	9.80%	15.30%	14.00%	20.50%	14.00%	13.50%	

Për ta kuptuar se çfarë i formon perceptimet për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, të anketuarit u pyetën për arsyet për opinionin e tyre për shtrirjen e korrupsionit. Ngjashëm me anketat e tjera në të shkuarën, gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve (70.9%) i kanë formuar opinionet e tyre përmes mediave të shkruara dhe digjitale, siç ilustron në Figurën 9 më poshtë. Gjithsej 25.3% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë e formojnë bazën e opinioneve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit, ndërsa 3.6% e të anketuarve pohuan se në opinionet e tyre kanë ndikuar përvojat personale kur atyre iu janë kërkuat para, dhurata ose favore të tjera në këmbim të shërbimeve të caktuara.


FIGURA 9 Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë



QËNDRIMET KUNDREJT VOTIMIT


Anketa e opinionit e Pulsit Publik e nëntorit 2022 i hulumtoi edhe qëndrimet e qytetarëve të Kosovës ndaj votimit. Qëndrimet ndaj votimit kanë ndryshuar krahasuar me anketën e opinionit të prillit 2022, duke treguar një ulje të besimit në efektin e votës së popullit për të shkaktuar ndryshime politike. Gjithashtu, numri i atyre që nuk besuan se vota e tyre mund të ndikojë në ndryshime ishte më i lartë sesa ata që besojnë se vota e tyre mund të ndikojë në ndryshime. Në pyetjen nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 31.2% e të anketuarve deklaruan se besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, krahasuar me 38.1% në prill 2022, 29.4% në vjeshtën 2021 dhe 43.8% në maj 2021. Nga ana tjetër, 32.4% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, krahasuar me 26.6% në prill 2022, 36.1% në vjeshtën 2021 dhe 25.1% në maj 2021. Në nëntor 2022, 31.4% e konsideronin se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në një farë mase, krahasuar me 32.9% në prill 2022. Gjithsej 5.1% nuk e dinin nëse vota e tyre mund të ndikojë në ndryshime ose refuzuan të përgjigjen, krahasuar me 2.7% në prill 2022.

FIGURA 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë




Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë treguan një rënie të besimit në lidhje me fuqinë e votës së tyre për të ndikuar në ndryshime si midis femrave ashtu edhe meshkujve në krahasim me prillin 2022. Ndërkohë që 32% (40.1% në prill 2022) e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 30.5% (35.9% në prill 2022) e femrave mendojnë të njëjtën gjë. Gjithsej 33.3% e meshkujve dhe 31.4% e femrave besojnë se vota e tyre nuk mund të sjellë ndryshime, ndërsa 31.7% e meshkujve dhe 30.9% e femrave mendojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku.

FIGURA 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë




Si në anketën e mëparshme, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet komuniteteve në Kosovë në besimin e tyre tek zgjedhjet si mekanizëm për ndryshim. Përgjithësisht, vërehet një rënie e besimit tek vota e tyre si mekanizëm për ndryshim tek shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës, dhe tek pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Vetëm 1% e serbëve të Kosovës (6.7% në prill 2020) konsiderojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë, përkundëjt 12% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (15% në prill 2022) dhe 33.3% të shqiptarëve të Kosovës (40.5% në prill 2022). Ndërkohë që gjithsej 46% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime (52% në prill 2022), të njëjtën gjë mendonin edhe 44.8% e serbëve të Kosovës (24.8% në prill 2022) dhe 30.9% e shqiptarëve të Kosovës (25.6% në prill 2022). Ashtu si në tre anketat e fundit (prill 2022, vjeshtë 2021 dhe maj 2021), më i larti është numri i serbëve të Kosovës që besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku (38.1%), ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (35.5%) dhe shqiptarët e Kosovës (31.3%).

FIGURA 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë



Anketa e Pulsit Publik e nëntorit 2022 hulumtoi edhe për gjasat që të anketuarit të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, si dhe preferencat e tyre për votim. Gjetjet tregojnë një rënie të gjasave për të votuar në mesin e të anketuarve në krahasim me prillin 2022. Gjithsej 69% e të anketuarve (76.7% në prill 2022) do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin së shpejti. Në vlera pothuajse identike me rezultatet e anketës së prillit 2022, 11.9% e të anketuarve nuk do të votonin (11.1% në prill 2022), 10.5% nuk kanë ndonjë preferencë politike (6.8% në prill 2022) dhe 7.6% refuzuan të përgjigjen.


FIGURA 13 Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti



Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan dy trende në nëntor 2022: së pari, kishte një rënie të gjasave për të votuar si mes meshkujve ashtu edhe mes femrave, dhe e dyta, ngjashëm me anketën e mëparshme - më shumë meshkuj sesa femra do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti. Më konkretisht, 70.6% e meshkujve dhe 67.6% e femrave do të kishin votuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin në të ardhmen e afërt. Në prill 2022, këto shifra ishin 81.1% për meshkujt dhe 76.8% për femrat, ndërsa në maj 2021 ishin 83.7% për meshkujt dhe 82% për femrat. Këto shifra janë të dyja më të ulëta se në dhjetor 2020, kur 93.4% e meshkujve dhe 92.2% e femrave deklaruan se do të votonin.

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike sugjerojnë rritje të dukshme të gjasave për të votuar në mesin e serbëve të Kosovës (71%) krahasuar me 52.4% në prill 2022. Gjithsej 57.6% e serbëve të Kosovës thanë se do të votonin në vjeshtë 2021 dhe 42.9% në maj 2021, dhe 59.1% kishte gjasa të votonin në dhjetor 2020. Gjasat e shqiptarëve të Kosovës për të votuar janë ulur ndjeshëm, me 68.6% që do të votonin, krahasuar me 79.5% në prill 2022, vjeshtë 2021 (77.5%) dhe maj 2021 (77.3%). Më pak pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës do të votonin në nëntor 2022 (74%) sesa në prill 2022 (88%) dhe vjeshtë 2021 (78%), por më shumë se në maj 2021 (70.2%). Gjithsej 10.9% e shqiptarëve të Kosovës (7.4% në prill 2022, 6.9% në vjeshtë 2021 dhe 5.8% në maj 2021), 1.9% e serbëve të Kosovës (5.7% në prill 2022 dhe vjeshtë 2021 dhe 14.8% në maj 2021), dhe 7.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (4.5% në prill 2022, 6% në vjeshtë 2021 dhe 9.5% në maj 2021) nuk kishin preferenca politike, ndërsa 11.5% e shqiptarëve të Kosovës (9.6% në prill 2022, 10.9% në vjeshtë 2021 dhe 9.6% në maj 2021), 23.3% e serbëve të Kosovës (18.6% në prill 2022, 17.1% në vjeshtë 2021 dhe 22.9% në maj 2021), dhe 9% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (6% në prill 2022, 9% në vjeshtë 2021 dhe 9.5% në maj 2021) deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti. Gjithsej 9.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, ndjekur nga 7.8% e shqiptarëve të Kosovës dhe 3.3% e serbëve të Kosovës, refuzuan të përgjigjen në këtë pyetje.


FIGURA 14 Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike



MJEDISI


Të anketuarit u pyetën edhe për njohuritë e tyre në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Anketa e opinionit e Pulsit Publik e nëntorit 2022 tregon se ka një ndryshim tek qytetarët që pretendojnë se kanë më shumë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër në krahasim me prillin 2022. Gjithsej 10.2% (15.3% në prill 2022, 7.9% në vjeshtën e 2021 dhe 16.1% në maj 2021) thanë se dinë shumë për këtë temë; 29.2% (25.5% në prill 2022, 24.9% në vjeshtën e 2021 dhe 32.7% në maj 2021) pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 41% (40.7% në prill 2022, 39.7% në vjeshtën e 2021 dhe 36% në maj 2021) thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 19.6% (18.5% në prill 2022, 27.5% në vjeshtën e 2021 dhe 15.2% në maj 2021) thanë nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

FIGURA 15 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër




Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme në mes të komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijesimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 46.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 32.9% e serbëve të Kosovës dhe 18% e shqiptarëve të Kosovës deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje, gjë që (përveç mes serbëve të Kosovës) tregon rritje të mungesës së njohurive krahasuar me prillin 2022 (38.6% e serbëve të Kosovës, 34.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 17.1% e shqiptarëve të Kosovës). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve (46.5%) që deklaruan se nuk kanë njohuri mbi këtë temë. Shqiptarët e Kosovës e përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve me njohuri mesatare në lidhje me temën (29.8%). Shqiptarët e Kosovës gjithashtu kryesuan për njohuri të pakta rreth kësaj teme (41.3%) si dhe për njohuri të shumta rreth kësaj teme (10.9%), ndjekur nga serbët e Kosovës (3.3%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (2%).

FIGURA 16 Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike




Anketa e opinionit e Pulsit Publik e nëntorit 2022 shqyrtoi edhe vetëdijesimin e të anketuarve rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Teksa 8.9% (9% në prill 2022 dhe 5.1% në vjeshtën e 2021) e të anketuarve deklaruan se ishin plotësisht të vetëdijshëm për këto kërcënime, 72.3% (73.9% në prill 2022 dhe 67.9% në vjeshtën e 2021) e të anketuarve deklaruan se kishin pak njohuri ose njohuri mesatare rreth këtyre kërcënimeve. Gjithsej 18.8% (17.1% në prill 2022 dhe 27% në vjeshtën e 2021) e të anketuarve deklaruan se nuk kishin njohuri rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Ashtu si në anketën e mëparshme, të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (8.8%) dhe femrat (9%) kanë njohuri të ngjashme për këtë temë. Më shumë meshkuj (29%) sesa femra (23.4%) kishin njohuri mesatare për këtë temë, por më pak meshkuj (44.1%) sesa femra (48.1%) kanë njohuri të pakta për këtë temë. Pak më shumë femra (19.5%) sesa meshkuj (18.2%) pohojnë se nuk kanë njohuri për këtë temë.

FIGURA 17 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre



Siç shihet në Figurën 18 më poshtë, të dhënat e zberthyer sipas përkatësisë etnike i nxjerrin në pah dallimet mes njohurive të grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, si dhe dallimet me anketën e prillit 2022. Gjithsej 45% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, 27.1% e serbëve të Kosovës dhe 17.5% e shqiptarëve të Kosovës, deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë temë. Dallimi më i madh në krahasim me anketën e prillit ishte rritja e numrit të komuniteteve të tjera të Kosovës (29.5%) dhe rënia e numrit të serbëve të Kosovës (32.4%) që nuk kishin njohuri për këtë temë. Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri për temën (55%). Serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës njëjloj kishin pak njohuri për këtë temë (46.2%). Shqiptarët e Kosovës kryesojnë me njohuri mesatare (26.7%), pak më shumë sesa pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (23%) dhe serbët e Kosovës (22.4%). Me një përqindje të barabartë si anketa e mëparshme, shqiptarët e Kosovës gjithashtu kryesuan me shumë njohuri për këtë çështje (9.6%), ndjekur nga serbët e Kosovës (4.3%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (1.5%).


FIGURA 18 Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zberthyer sipas përkatësisë etnike



Për të tretën herë radhazi, anketa e opinionit e Pulsit Publik hulumtoi edhe vetëdijesimin për ndryshimet klimatike. Gjithsej 17.8% (18% në prill 2022 dhe 12.3% në vjeshtën e 2021) besojnë se Kosova është e ndikuar nga ndryshimet klimatike dhe 60.9% (63.4% në prill 2022 dhe 49.7% në vjeshtën 2021) besojnë se është e ndikuar deri diku nga ndryshimet klimatike. Gjithsej 20.9% (16% në prill 2022 dhe 30.7% në vjeshtën e 2021) besojnë se ndryshimet klimatike kanë pak ndikim, ndërsa 2.2% (2.8% në prill 2022 dhe 7.3% në vjeshtën e 2021) besojnë se ndryshimet klimatike kanë shumë pak ndikim në Kosovë. Të dhënat e zberthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime madhore ndërmjet opinionit të meshkujve dhe femrave për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë: gjithsej 78.5% e meshkujve (83.2% në prill 2022 dhe 61.6% në vjeshtën e 2021) dhe 75.4% e femrave (79.3% në prill 2022 dhe 62.6% në vjeshtën e 2021) besojnë se Kosova është shumë ose deri diku e ndikuar nga ndryshimet klimatike, ndërsa 21.6% e meshkujve (16.8% në prill 2022 dhe 38.3% në vjeshtën e 2021) dhe


24.6% e femrave (20.5% në prill 2022 dhe 37.4% në vjeshtën e 2021) besojnë se Kosova është pak ose shumë pak e ndikuar nga ndryshimet klimatike.

FIGURA 19 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë



Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se 78.2% (82.5% në prill 2022 dhe 62.7% në vjeshtën e 2021) e shqiptarëve të Kosovës besonin se Kosova është e ndikuar shumë dhe deri diku nga ndryshimet klimatike, ndjekur nga 67.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (64.5% në prill 2022 dhe 66% në vjeshtën e 2021) dhe 56.7% e serbëve të Kosovës (64.3% në prill 2022 dhe 51.9% në vjeshtën e 2021). Këta të fundit udhëheqin (43.3%) në besimin se Kosova ndikohet pak dhe shumë pak nga ndryshimet klimatike (35.7% në prill 2022 dhe 48% në vjeshtën e 2021), ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (32.5% kundrejt 35.5% në prill 2022 dhe 34% në vjeshtën e 2021) dhe shqiptarët e Kosovës (21.9% kundrejt 17.5% në prill 2022 dhe 37.4% në vjeshtën e 2021).

FIGURA 20 Vetëdija e të anketuarve për ndikimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë, të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë etnike



METODOLOGJIA

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje bazohen në anketën e opinionit me 1,306 të anketuar në Kosovë mbi moshën 18 vjeçare, të realizuar nga 21 tetori deri më 3 nëntor 2022. Mostra përfshiu numër të njëjtë të meshkujve dhe femrave nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke i mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Në aspektin e përfaqësimit etnik, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës). Anketa u krye në bazë të mostrimit me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u krye përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.⁵

PESHIMI I TOTALEVE TË POPULLATËS

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totalët, ekipi i Pulsit Publik e bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

Shqiptarë të Kosovës:

88%

Serbë të Kosovës:

6%

Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës:

6%

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92.93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë të Kosovës	8,824	0.51
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarohen dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

⁵ Në raport përdoren termat përqindje dhe pikë përqindjeje. Një pikë përqindjeje është ndryshimi numerik mes dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes mat sasinë reale të ndryshimit.

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

Shqiptarë të Kosovës:

93%

Serbë të Kosovës:

2%

Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës:

5%

Megjithatë, marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet të shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të konsideruar për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

Shqiptarë të Kosovës:

92%

Serbë të Kosovës:

4%

Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës:

4%

PËRLLOGARITJA E INDEKSEVE

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse institucionet lokale dhe ato ekzekutive qendrore punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 deri në 1.5 do të thotë që shumica e të anketuarve konsiderojnë se demokratizimi nuk është në rrugën e duhur, kurse rezultati prej 1.5 deri në 3 do të thotë që shumica e të anketuarve pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.

